



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Investimet vetjake të KRU-ve në sektorin e ujit në Kosovë

Monitorimi i realizimit të investimeve kapitale nga burimet vetjake të financimi (tarifat e shërbimeve) krahasuar me BPRR 2022/2024 të miratuar nga ARRU për vitin 2024



Përmbajtja

Hyrje	3
Përmbledhje ekzekutive	4
Realizimi i caktit të investimeve (shprehur në përqindje)	5
Shërbimet e ujësjellësit	7
Konkluzione	10
Rekomandime	11

Hyrje

Investimet e ofruesve të shërbimeve, nga burimet vetjake të financimit, në sektorin e shërbimeve me ujë dhe ujëra të ndotura, paraqesin një rëndësi të veçantë për Rregullatorin dhe vetë sektorin e ujit. Investimet kapitale janë të mbuluara me tarifën e shërbimeve të vitit 2024, të cilën e kanë paguar konsumatorët për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura. Pjesa tjetër e investimeve materializohet në volumin e ‘Bazës Rregullatorë të Aseteve’, e cila në vijim, iu kthehet ofruesve të shërbimeve, përmes ‘Normës së kthimit në kapital’. Prandaj, realizimi i këtyre investimeve është me rëndësi jetike, jo vetëm se konsumatorët i kanë paguar me tarifën e shërbimeve, por rëndësi ka kjo ekuivalencë edhe për nivelin e ofruar të shërbimeve. Departamenti i Tarifave, i prirë nga rëndësia e realizimit të këtyre investimeve, ka hartuar plan të veprimit, për monitorimin e realizimit të këtyre investimeve. Jo vetëm kaq - Departamenti i Tarifave, e ka monitoruar këtë realizim, projekt – për projekt, duke e fituar fotografinë reale të zhvillimit dhe ecurisë së këtyre projekteve. Do theksuar se ofruesit e shërbimeve kanë realizuar më shumë investime, se sa është pasqyruar në këtë raport. Sipas ‘Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator’, investimet plasohen në librat kontabël, vetëm atëherë kur të jetë bërë pranimi teknik i projektit. Vetëm projektet e realizuara dhe të pranuar teknikisht, janë të përfshira në raportin tonë. Rrjedhimisht, investimet në vijim, të pa përfunduara dhe të pa pranuar teknikisht, rrisin ndjeshëm vlerën financiare të investimeve reale të ndodhura në terren. Mos realizimi i investimeve kapitale do të ketë ndikim në proceset e ardhshme tarifore(2029/2031 dhe tutje), sepse atëherë do të balancohen kundërvlerat e këtyre investimeve të paguara me tarifë dhe të pa realizuara. Sidoqoftë, vizitat në terren, dëshmuar se ofruesit e shërbimeve kanë përmirësuar cilësinë e planeve të biznesit, evidencat kontabël dhe raportimin tek Autoriteti, edhe pse shoqërohen me mangësi të theksuara. Do theksuar se në raport nuk janë të përfshira investimet nga donacionet apo grantet, sepse fokusi i këtij monitorimi është investimi nga burimet e vetëfinancimit. Të dhënat nga realizimi i investimeve kapitale janë të harmonizuara me të dhënat e audituara nga ekipi i auditimit në ARRU, prandaj paraqesin fotografinë reale të gjendjes në terren.

Përmbledhje ekzekutive

Përgjatë vitit 2024, investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit, të planifikuara për ujë, gjithsej ishin 4,934,100.00 €, kurse të realizuara 4,138,207.00€, ose 83.90 %. Për shërbimet e ujërave të ndotura, gjithsej investime kapitale vetjake, të planifikuara ishin 1,419,040.00 €, kurse të realizuara 406,308.00€, ose vetëm 28.60%. Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe UN, në vitin 2024, të planifikuara ishin 6,353,140 .00 €, kurse të realizuara 4,544,515.00 €, ose 71.50 %.

- **KRU “Prishtina”** Nuk përmbushë cakun e investimeve kapitale, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2024. Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej, për ujë ishin planifikuar 1,616,600.00 €, prej të cilave u realizuan 762,013.00 €, apo shprehur në përqindje, 47.13% të investimeve. Gjithsej për ujë dhe ujëra të ndotura – të planifikuara ishin 2,213,600.00 €, kurse të realizuara ishin 830,861.00 € , apo 37.53 %. Caku rregullator nuk është përmbushur.
- **KRU “Mitrovica”** Nuk përmbushi cakun të investimeve kapitale, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2024, për ujë ishin 390,000.00 € - u realizuan 116,999.00 €, apo 30.00 %. Për ujëra të ndotura me BPRR ishin të planifikuara 150,000.00 €- të realizuara ishin 12,250.00, ose 8.2 %. Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej U&UN u planifikuan me BPRR-2024 540,000.00 €, kurse u realizuan 129,249.00 €, apo 23.93 %;
- **KRU “Hidrodrini”** Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej KRU-ja ka planifikuar 715,500.00 €, prej të cilave ka realizuar 1,320,479.00 €, apo shprehur në përqindje 184.55 % të investimeve. Pra caku rregullator për investime vetjake u realizua 184 %;
- **KRU “Hidroregjioni Jugor”** Gjatë procesit tarifor, për vitin 2024, KRU-ja kishte planifikuar investime në vlerë prej 677,000.00€- për shërbimet e ujësjellësit, por i ka realizuar ato në vlerë prej 691,741.00 €, apo 102.20 %. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 874,000.00 €, prej të cilave ka realizuar 795,137.00 €, apo shprehur në përqindje, vetëm 90.97 % . Caku rregullator është realizuar 90 %;
- **KRU “Gjakova”** Gjatë procesit tarifor, për vitin 2024, KRU-ja kishte planifikuar investime për shërbimet e ujësjellësit në vlerë prej 937,480.00 €, kurse i ka realizuar 666,116.00 €, apo 79.09 %. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total(U&UN) KRU-ja ka planifikuar 1,133,480.00 €, prej të cilave ka realizuar 764,497.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar vetëm 71.10 % të investimeve. Caku rregullator-i pa realizuar.
- **KRU “Bifurkacioni”** Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 311,990.00 € prej të cilave ka realizuar 310,425.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 99.50 % të investimeve. Caku i përcaktuar rregullator gati është përmbushur 100%.
- **KRU “Hidromorava”** Gjatë procesit tarifor, për vitin 2024, KRU-ja kishte planifikuar investime për shërbimet e ujësjellësit në vlerë prej 335,530.00 €, kurse i ka realizuar 421,796.00 €, apo 125.70 %. Për ujëra të ndotura me BPRR të miratuara ishin 116,112.00 €, kurse të realizuara ishin 53,866.00, apo 46.40 %. Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej U&UN, KRU-ja ka planifikuar 541,642.00 € prej të cilave ka realizuar 475,662.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 105.31 % të investimeve. Caku i përcaktuar rregullator u realizua.

Realizimi i caktut të investimeve (shprehur në përqindje)

Investimet kapitale nga burimet vetjake të financimit, për ujë në vitin 2024, ishin gjithsej të planifikuara 4,934,100.00 €, kurse u realizuan 4,138,207.00, apo 83.86 %. Investimet kapitale nga burimet vetjake të financimit, për ujëra të ndotura, në vitin 2024, ishin gjithsej të planifikuara 1,419,040.00 €, kurse të realizuara ishin 406,308.00 €, apo 29.00 %. Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe UN, në vitin 2024, të planifikuara ishin 6,353,140.00 €, kurse të realizuara ishin 4,544,515.00 €, ose 71.50 %. Caku i përcaktuar rregullator për investimet vetjake në sektor nuk është përmbushur.

Tabela Nr.1 Investimet vetjake për ujë për vitin 2024

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar	Vlera e realizuar
			Financuar nga KRU	Financuar nga KRU
Resurse dhe trajtim	Infrastrukturë	Përteritje	1,562,206	496,017
		Rritje	268,000	370,770
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	1,285,414	361,545
		Rritje	445,000	102,127
Distribuum	Infrastrukturë	Përteritje	746,480	708,688
		Rritje	480,000	330,658
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	0	115,517
		Rritje	122,000	704,047
Aktivitete Biznesore	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	25,000	118,265
		Rritje	0	830,573
Totali			4,934,100	4,138,207

Tabela nr. 2 Investimet vetjake ujëra të ndotura për vitin 2024

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar	Vlera e realizuar
			Financuar nga KRU	Financuar nga KRU
Grumbullim	Infrastrukturë	Përteritje	641,680	16,868
		Rritje	0	136,328
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	486,360	0
		Rritje	0	47,624
Trajtimi i ujërave të ndotura	Infrastrukturë	Përteritje	97,000	0
		Rritje	50,000	0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	82,000	1,220
		Rritje	0	9,709
Trajtimi i Llumit	Infrastrukturë	Përteritje	0	0
		Rritje	0	0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	0	0
		Rritje	0	0
Aktivite Biznesore	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	62,000	17,151
		Rritje	0	177,408
Totali			1,419,040	406,308

Shërbimet e ujësjellësit

Gjatë vitit 2024, gjithsej investime të planifikuara me BPRR-2024 në infrastrukturë ishin 788,680.00 €, kurse të realizuara ishin 153,196.00€. Në jo infrastrukturë, të planifikuara me BPRR-2024, ishin gjithsej 630,360.00 €, kurse të realizuara ishin 253,112.00 €.

Tabela nr. 3 Realizimi i investimeve vetjake ujë Infrastrukturë dhe jo infrastrukturë

Emërtimi	Të aprovuara	Të realizuara nga sektori
Infrastrukturë	788,680.00	153,196.00
Jo Infrastrukturë	630,360.00	253,112.00
Totali	1,419,040.00	406,308.00

Investimet e kategorizuara, sipas kosto – qendrave, duken kështu:

Në kosto -qendrën ‘Resurse’ të planifikuara me BPRR-2024 – ishin 3,560,620.00 €, ndërsa të realizuara ishin 1,330,459.00 €, apo 37.36 %.

Për kosto qendrën e ‘Distribuimit’, të planifikuara me BPRR-2024- ishin 1,348,480.00, kurse të realizuara ishin 1,858,910.00, ose 137.85% €.

Për kosto – qendrën ‘Aktivitete të Përbashkëta’, të planifikuara me BPRR-2024, ishin 25,000.00 €, ndërsa të realizuara ishin 948,838.00€, apo 3,795.35 %.

Gjithsej të planifikuara ishin 4,934,100.00 €, kurse të realizuara ishin 4,138,207.00 €, apo 83.86 %.

Tabela nr. 4 Realizimi i investimeve vetjake sipas kosto qendrave ujë

Emërtimi	Të aprovuara	Të realizuara nga sektori
Resurse	3,560,620.00	1,330,459.00
Shpërndarje	1,348,480.00	1,858,910.00
Aktivitete të përbashkëta	25,000.00	948,838.00
Totali	4,934,100.00	4,138,207.00

Tabela nr. 6 Kategorizimi i investimeve vetjake në ujëra të ndotura infrastrukturë dhe jo infrastrukturë

Emërtimi	Të aprovuara	Të realizuara nga sektori
Infrastrukturë	3,056,686.00	1,906,133.00
Jo-infrastrukturë	1,877,414.00	2,232,074.00
Totali	4,934,100.00	4,138,207.00

Tabela nr. 7 Kategorizimi i investimeve vetjake në ujëra të zeza sipas kosto qendrave

Emërtimi	Të aprovuara	Të realizuara nga sektori
Grumbullim	1,128,040.00	200,820.00
Trajtimi i UN	229,000.00	10,929.00
Trajtim llumi	-	-
Aktivitete biznese	62,000.00	194,559.00
Totali	1,419,040.00	406,308.00


Tabela nr. 9 Realizimi i investimeve vetjake në ujë dhe ujëra të ndotura

Investime Vetjake	Planifikuara në €	Realizuar në	Përqindja
Ujë	4,934,100.00	4,138,207.00	83.9 %
Ujëra të ndotura	1,419,040.00	406,308.00	28.6 %
Totali	6,353,140.00	4,544,515.00	71.50 %

Tabela nr. 10 Investimet vetjake të realizuara edhe në përqindje

KRU	Ujë	UN	Totali	Realizuar
Prishtina	762,013.00	68,848	830,861	37.5 %
Hidroregjioni Jugor	691,741.00	103,396.00	795,137.00	90.97 %
Hidrodrini	1,169,117.00	151,362.00	1,320,479.00	184.55 %
Mitrovica	116,999.00	12,250.00	129,249.00	23.93 %
Gjakova	666,116.00	11,430.00	677,546.00	59.77 %
Bifurkacioni	310,425.00	5,155.60	315,580.60	74.26 %
Hidromorava	421,796.00	53,866.00	475,662.00	105.31 %
Totali	4,138,207.00	406,308.00	4,544,514.60	71.53 %

Paraqitje grafike



Realizimi i investimeve të financuara nga KRU

Konkluzione

- Përmbushje e caktut të investimeve kapitale vetjake në sektor, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2024, është në masën 71.50 % ;
- Përgjatë vitit 2024, investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit për ujë, të planifikuara gjithsej ishin 4,934,100.00 €, kurse të realizuara 4,138,207.00 €, ose 83.90 %;
- Për shërbimet e ujërave të ndotura, gjithsej investime kapitale vetjake, të planifikuara ishin 1,419,040.00 €, kurse të realizuara 406,308.00 €, ose vetëm 28.60 %;
- Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe UN, në vitin 2024, të planifikuara ishin 6,353,140.00 €, kurse të realizuara 4,544,515.00 €, ose 71.50 %;
- Ofruesit e shërbimeve kanë dështuar për ta sjellë në ARRU azhurnimin e ‘Listës së investimeve kapitale nga burimet vetjake të financimit’, pas ndërhyrjeve rregulluese nga Departamenti i Tarifave;
- Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit, ofruesit e shërbimeve, nuk i kanë realizuar sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve ka shumë rëndësi në nivelin e shërbimit, njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa;
- Në kategorinë e investimeve - infrastrukturë e ujërave të ndotura, me mjetet vetjake të financimit, KRU-të nuk kanë bërë investime sipas planifikimeve, as në destinim dhe as në vlerë financiare, të përcaktuar nga miratimet rregullatorë;
- Mos realizimi i investimeve kapitale, tek disa ofrues shërbimesh, ishte ndikuar nga vonesat në procedurat e prokurimit, kërkesave nga donatorët për ndërhyrje emergjente, problemet financiare, nga keq menaxhimi etj.;
- Ka mangësi tek kontimi i shpenzimeve të ujërave të ndotura, rezultuar si shpenzime - jo reflektuese;
- Dështon mbështetja e plotë në Planin e Menaxhimit të Aseteve(PMA), duke rezultuar me planifikim jo të mirë sipas prioriteteve të projekteve të investimeve kapitale, njëherësh, edhe arsyetimi i projekteve ka pasur mangësi;
- Ofruesit e shërbimeve dështojnë për të bërë Planifikim të Investimeve Afatgjata(PIA), përjashtimisht dy kompanive. Po ashtu edhe kjo e ka kufizuar burimin për një plan të mirë biznesi, rrjedhimisht, realizimin e investimeve sipas prioriteteve të mirëfillta profesionale.
- Ofruesit e shërbimeve kanë dështuar për të sjellë Plan Biznesi të njëjtë në ARRU, sikurse në NPMNP;
- Për gjithë këto mangësi, ARRU ka hezitur për ta sanksionuar kompaninë dhe bartësit individualë të përgjegjësive;
- Ofruesit e shërbimeve, dështuan që të kërkojnë nga ARRU aprovimin e ndryshimeve në projektet e aprovuara me BPRR;
- Ofruesit e shërbimeve nuk kishin zë të shpenzimeve për kontigjenca dhe për investime të pa planifikuara;
- Ofruesit e shërbimeve po vuajnë akoma nga evidenca kontabël jo efikase, sepse investimet e deklaruara nga ata, rezultojnë jo të sakta me auditimin që e bënë Departamenti i Performancës si bartës i procesit dhe i asistuar edhe nga Departamenti i Tarifave.

Rekomandime

- Ofruesit e shërbimeve duhet që ta njëjtësojnë Planin e Biznesit të ARRU-së me atë të NPMNP-së;
- Ofruesit e shërbimeve duhet ta braktisin praktikën e mos dorëzimit në ARRU ‘Listën e Azhurnuar të Investimeve kapitale’, pas ndërhyrjeve rregullatore, me BPRR të miratuar;
- Ofruesit e shërbimeve duhet që ta përmirësojnë cilësinë e Plan Biznesit, duke u mbështetur në Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe PIA;
- Për investimet e pa realizuara kapitale, gjatë viteve vijuese, në procesin e ardhshëm tarifor 2029-2031, ARRU do të ndërmerr veprime rregulluese sipas Rregullores Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë, si dhe në bazë të dokumenteve të ndryshimeve metodologjike, në procesin e aprovimit të tarifave të shërbimit;
- Rekomandojmë që KRU-të të jenë të vëmendshme që për shkak të procedurave të prokurimit, problemeve financiare, ndërrimeve të fundit të menaxhmentit, që të angazhohet, që këto të mos ndikojnë në mos realizimin e investimeve kapitale;
- Rekomandojmë KRU-të, që të angazhohen më shumë në finalizimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve, i cili pasqyron gjendjen reale të asetëve të kompaniv;.
- Rekomandojmë KRU-të që të kenë koordinim më të mirë me komunën dhe donatorët e tjerë në mënyrë që planifikimet të bëhen me kohë dhe sipas prioriteteve dhe të përfshihen saktë në aplikacionin tarifor;
- Rekomandojmë KRU-të, që të bëjnë planifikim të saktë sipas prioriteteve, që shpijnë kah efienca më e mirë dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit, duke evidentuar humbjet e dukshme dhe duke adresuar ato;
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve, që të jenë të vëmendshëm që, investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit, t’i realizojnë sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve, për ARRU, ka shumë rëndësi në nivelin e shërbimit, njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa.
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që ta hartojnë ‘Planin e Investimeve Afatgjata’, sa më parë që është e mundur;
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që, të mos bëjnë asnjë ndryshim të projekteve nga BPRR, pa aprovimin e Autoritetit;
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që të planifikojnë shpenzimet e kontigjencave si dhe planifikim në vlerë financiare për projektet e pa planifikuara;
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që t’i evitojnë këto mangësi.
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve për mangësitë e kualitetit të të dhënave, të cilat i kërkon ARRU-ja, duke gjetur mangësi për çdo vit auditimi i ARRU-së dhe ofruesit nuk ndërmarrin veprime efikase për t’i eliminuar ato.